




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

13 -01- 2021

Ref. 2101/013/BA/74

Nr. 02/2021

**Bordi për Ankesa**, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën Nr. Ref.2012/958/KPM/nr të datës 07.12.2020 të parashtruesit “Grupi Koha SH.P.K” të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresën Rrugën Robert Dolli Nr.34 Prishtinë, të paraqitur ndaj Vendimit Ref: 2011/835/KPM/xhl, të datës 30.10.2020 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 06.01.2021 mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar Ankesa Nr. Ref.2012/958/KPM/nr të datës 07.12.2020 të parashtruesit “Grupi Koha SH.P.K” dhe të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresën Rrugën Robert Dolli Nr.34 Prishtinë, dhe mbetet në fuqi Vendimit Ref: 2011/835/KPM/xhl, i datës 30.10.2020. të Komisionit të Pavarur të Mediave.

### A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr. 2011/835/KPM/xhl, i datës 30.10.2020, e ka obliguar që në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të këtij vendimi të ofroj palës ankuese të drejtën e reagimit në hapësirën e njëjtë dhe në kohë të njëjtë në mënyrë që të vepron në pajtim me kodin e Etikës KKPM -2016/03, dhe ashtu siç përcaktohet me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe sanksionon me vërejtje, në pajtim me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

Kundër këtij vendimi në afatin e paraparë ligjor “Grupi Koha SH.P.K me datë 07.12.2020 ka parashtruar ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, procedurave për vënien e sanksioneve dhe sanksionit të shqiptuar me propozim që Bordi për Ankesa, të aprovojë ankesën si të bazuar në tërësi dhe të anulojë vendimin e kundërshtuar.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 06.01.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Grupi Koha S.H.P.K”, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref: 2011/835/KPM/xhl, të datës 30.10.2020 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa, konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale përkatësisht në nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitat procedurale që rregullojnë fushën e KPM-së.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10, paragrafi 2, i Rregullores Nr. BA 2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:  
-Palëve dhe  
-Arkivit të KPM-së.



Yllë Fetahaj  
Kryetar i Bordit për Ankesa